

**BRITISH COUNCIL ALBANIA
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË**



Thirrje për 2 (dy) ekspertë për trajnim të Punonjësve Rinorë të bashkive Dibër, Kukës, Mat, Bulqizë, Klos, Has, Tropojë, Malësi e Madhe.

Ditë pune: 2 (dy)

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) është institucion publik i cili garanton dhe promovon të drejtat e të rinjve nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimet e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në bazë dhe për zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

Veprimtaria e AKR-së shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim sigurimin e kushteve për mbështetjen dhe nxitjen e veprimtarive rinore, zhvillimin e dialogut të strukturuar për të realizuar fuqizimin e pozitës së të rinjve në shoqëri, krijimin e mekanizmave për nxitjen e politikave rinore si dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilësore e të pavarura, në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve që kanë në fokus rininë shqiptare dhe rëndësinë e kësaj të fundit në shoqëri.

Përshkrimi i punës

Nëpërmjet këtij aktiviteti 2-ditor, punonjësit rinor të bashkive Dibër, Kukës, Mat, Bulqizë, Klos, Has, Tropojë, Malësi e Madhe do të pajisen me njohuri lidhur me mënyrat e përfshirjes së të rinjve në vendimmarrje në nivel lokal. Gjithashtu, trajnimi do të ketë në fokus rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetin e punonjësve rinor në punën me të rinjtë bazuar në edukimin jo-formal.

Ky aktivitet ka në fokus përmirësimin e cilësisë së punës rinore dhe rritjes së ndikimit të programeve rinore në komunitet përmes krijimit të modeleve të reja për pjesëmarrje aktive. Duke u ofruar punonjësve rinorë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme, ne synojmë të sigurojmë që ata të kenë mbështetjen dhe trajnimin e duhur për të arritur objektivat e tyre dhe për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të rinisë në Shqipëri.

Termet e Referencës të trajnimit.

- Të pajisë punonjësit rinorë me aftësitë dhe mënyrat për të angazhuar të rinjtë në mënyrë aktive në komunitetet e tyre.

- Të aftësoj punonjësit rinorë me strategjitë dhe qasje të suksesshme për nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve.
- Të rris ndërgjegjësimin për përfitimet e pjesëmarrjes së të rinjve në komunitet.

Kualifikimet dhe përvojat e Ekspertit:

- Diplomë Master në Shkenca Sociale, Ekonomike, Juridike ose fusha të ngjashme.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi.
- Njohje e shkëlqyer e gjuhës angleze.
- Njohuri mbi strukturat rinore, procedurat dhe proceset e këshillave vendor rinor në nivel lokal dhe kombëtar.
- Aftësi për të zhvilluar një trajnim të qartë teorik dhe praktik për përfshirjen e të rinjve.
- Aftësi për të strukturuar informacionin në mënyrë të qartë dhe të arritshme për audiencën.
- Njohuri për kontekstin social të të rinjve në Shqipëri dhe rajon.
- Përvojë në bashkëpunimin me ekipe multidisiplinare dhe aktorë të ndryshëm, përfshirë përfaqësues të organizatave rinore dhe/ose ndërkombëtare qeverisë dhe shoqërisë civile.

Procesi i Aplikimit

- Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë CV-në dhe një letër motivuese duke detajuar përvojën e tyre relevante deri më datë 21 Shkurt 2025 ora 16:30 në adresën e e-mailit: info@rinia.gov.al.

Fazat e Vlerësimit

- Fazat për vlerësimin e aplikimeve do të jenë:
 - **Faza 1:** Vlerësimi i Kualifikimeve dhe përvojave bazuar në këtë dokument;
 - **Faza 2:** Intervista me Komisionin e Vlerësimit.

(Aplikantët që kalojnë fazën e parë do lajmërohen zyrtarisht për ditën dhe orën e intervistës).

Agjencia Kombëtare e Rinisë është një institucion që promovon mundësitë e barabarta dhe inkurajon të kandidatët që plotësojnë kriteret të aplikojnë.

Shënim: Termat e mësipërme të referencës janë dhënë si një udhëzues i përgjithshëm dhe mund të jenë subjekt i modifikimit bazuar në nevojat në zhvillim të projektit.